

Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR
NR 60 -- VITI XV -- TM4 2022

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-2.10%	+2.19%	-5.54%	+7.69%	+11.06%	+62.68%
BENÇMARKU*	+0.87%	+2.72%	+12.10%	+19.72%	+24.66%	+66.36%

*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

LËVIZJET MUJORE

MUAJI	NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT		KTHIMI BRUTO STANDARD (MLN)	KTHIMI BRUTO KONSERVATIV (MLN)
	STANDARD	KONSERVATIV		
Tetor	+3.33%	+0.29%	€75.07	€0.28
Nëntor	+1.02%	+0.28%	€24.36	€0.28
Dhjetor	-2.10%	+0.29%	€(48.67)	€0.29
Tremujori	+2.19%	+0.85%	€50.76	€0.85

KONTRIBUIMI

	KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN)	KONTRIBUTET E REJA KONSERVATIV (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
Tetor	€23.53	--	3,945	414,781
Nëntor	€19.88	--	3,508	422,211
Dhjetor	€20.99	--	3,122	428,891
Tremujori	€64.40	--	11,368	421,961*

*Mesatarja tremujore

PENSIONIMET

	TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR
Tetor	504	€3,854,219
Nëntor	603	€3,873,813
Dhjetor	563	€3,827,728
Tremujori	1,670	€11,555,760

PËRMBLEDHJE SHIFRASH

	FUNDI TM4 2022	FUNDI TM3 2022
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€1.6268	€1.5919
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€2.0588	€2.0414
MJETET NETO NËN MENAXHIM STANDARD	€2,316,363,920	€2,222,209,985
MJETET NETO NËN MENAXHIM KONSERVATIV	€94,812,043	€87,020,748
NUMRI I LLOGARIVE GJITHSEJ	792,995	782,420
NUMRI I LLOGARIVE AKTIVE	428,891	405,922
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN	€1,858,973	€1,831,301
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN	€331,130	€326,200
INVESTIMET NË KOSOVË	€690,671,577	€646,115,734
INVESTIMET JASHTË	€1,689,250,011	€1,551,856,026
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€32,130,596	€112,999,267

PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM4 2022

MENAXHUESI FONDI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM4 2022	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€1,078,243.40	€2,717,919.90
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€224,068,596.99	€8,107,850.43
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€148,462,915.48	€3,169,025.26
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€200,172,086.11	€4,224,710.96
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FR0007038138	€382,119,647.39	€1,320,719.82
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€1,540,491.19	€46,146.19
BNP Climate Impact	LU0406802768	€2,223,725.51	€5,052.84
AXA WF - Framlington Digital Economy	LU1694772994	--	€(33,739.04)
T. Rowe - Global Technology Equity	LU1244139827	--	€(113,064.82)
Amundi Global Disruptive	LU1530899811	--	€53,108.14
Goldman Sachs Global Millennials	LU1820776075	--	€21,863.56
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	--	€1,281,276.57
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	--	€602,222.69
SP OilGas Expl ETF	US91232N2071	--	€995,462.56
WisdomTree Industrial Metals	GB00B15KYG56	--	€118,455.00
iShares Core Dividend Growth ETF	US46434V6213	--	€535,425.74
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	--	€(1,052,772.73)
US Infrastructure ETF	US37954Y6730	€60,062,495.85	€1,501,865.60
US Infrastructure Dev ETF	US46435U7138	€59,069,111.47	€1,473,282.39
iShares Edge S&P 500 Minimum Volatility	IE00BYX8XD24	€21,339,112.00	€676,867.12
Lyxor US\$ 10Y Inflation Expectations	LU1390062831	€75,868,821.60	--
Invesco DB Base Metals ETF	US46140H7008	€22,171,890.71	€1,935,582.59
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062245	€118,823,433.25	€1,392,842.37
Vanguard Value ETF	US9229087443	€67,214,477.87	€3,600,953.49
Invesco KBW Bank ETF	US46138E6288	€79,301,061.61	€(2,458,729.55)
iShares Edge MSCI Europe Val. Factor ETF	IE00BQN1K901	€53,615,660.69	€8,179,568.76
Lyxor EURO STOXX Banks ETF	LU1829219390	€56,943,837.57	€10,164,727.86
SPDR S&P Oil & Gas Explor. & Prod. ETF	US78468R5569	€55,544,737.55	€(17,394.38)
Global X Cybersecurity ETF	US37954Y3844	€29,529,066.60	€(2,183,587.31)
SPDR MSCI Europe Energy	IE00BKWQ0F09	€30,100,598.01	€(456,939.12)
Thesari i Republikës së Kosovës ¹⁾	Letra me vlerë të Qeverisë	€553,752,102.20	€3,507,173.18
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita bankare	€136,919,474.68	€474,391.86
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€28,860,632.43	--
Erste Bank (Broker) - dividenta	Të painvestuara	€3,269,838.33	€1,817,253.00
Të hyra të tjera	--	--	€7,913.03
Paraja në dorë dhe në tranzit	Të painvestuara	€125.00	--
GJITHSEJ		€2,412,052,183.49	€51,615,433.96

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

LAJME

EFEKTI I KRIZAVE
GLOBALE NË
INVESTIMET E
FKPK-SË

Viti 2022 ishte i vështirë për investitorët anembanë globit. Bankat qëndrore dhe inflacioni ishin çështjet kryesore të vitit, pasi normat në rritje dhanë korelacion të lartë midis aksioneve dhe obligacioneve. Portofoli tradicional 60/40 përgjithësisht zhgënjeu.

Lufta në Ukrainë çrregulloi tregun e energjisë dhe krijoi paqartësi të shumta gjeopolitike në Europë. Konsensusi për vitin 2023 është që ekonomia globale do të përjetojë recesion të lehtë, pasi politika e shtrënguar monetare do të krijojë presion të lartë në aktivitetin ekonomik. Në anën tjetër, vështirësitë në zinxhirin e furnizimit janë lehtësuar, ndërsa rihapja e Kinës do të ndikojë në përmisimin e aktivitetit global ekonomik.

Viti 2022 kishte filluar me vlerësime të larta për faktorin *Growth* të aksioneve. Pasi FED pranoi se inflacioni do të zgjasë më gjatë se pritej, vlerësimet për kompanitë që gjenorjnë nivele të rrjedhës së parasë (në faktorin *Growth*) ranë ndjeshëm pasi normat diskontuese u rritën. Norma terminale e FED u ngrit shpejt. Faktori *Value* mbiperformoi përgjatë vitit faktorin *Growth*, kurse mallrat ishin kategoria më e mirë sa i përket performancës. Norma e kthimit në obligacione qeveritare 10 vjeçare u ngrit ndjeshëm.

-Politika Monetare: Norma e FED aktualisht është rreth 4.5%. FED-i i ngriti normat bazë të interesit me +0.5% në takimin e fundit. Përkundër presioneve inflacioniste, FED ende i qëndron mbrapa qasjes shtrënguese monetare. Sidoqoftë, nëse inflacioni vazhdon të bjerë, bankat qëndrore pritet të pauzojnë trendin e ngritjes së normave bazë të interesit.

-Papunësia: Vendet e lira të punës si dhe punësimet përgjatë muajit ranë paksa në SHBA por ende mbesin më lartë se niveli i zakonshëm i ciklit aktual biznesor. Rritja e pagave vazhdon me trend stabil. Tregu i forte i punës mund të ndihmojë ekonominë amerikane të evitojë recesionin në 2023.

Portofoli i FKPK-së: Përkundër gjithë situatës së rëndë globale, kthimi i FKPK-së për muajin dhjetor 2022 ishte -2.1%, krahasuar me portofolin global 60/40 që ishte -3.5%. Performanca për vitin 2022 e FKPK-së ishte -5.5%, ndjeshëm më e mirë sesa performancat e indekseve kryesore: S&P500 (-19.4%), MSCI World Index (-18.3%), Dow Jones (-8.8%), Nasdaq -33.1%, Stoxx 600 (-12.8%), FTSE 100 (-19.7%), DAX 30 (-12.4%).

Matrica e alokimit strategjit të mjeteve pensionale në fund të vitit 2022

	Tregu i parasë	Të ardhura fikse	Multi-asete	Asete reale	Aksione	Gjithsej
Të hyra	17.8%	25.7%		--	2.4%	46.0%
Risk i menaxhuar	--	3.3%	18.3%	--	7.3%	28.9%
Drejtimore	--	--	--	6.4%	18.7%	25.1%
Gjithsej	17.8%	29.0%	18.3%	6.4%	28.4%	

PASQYRA E
LLOGARISË TANI
EDHE PËRMES
EKOSOVA

Prej fundit të dhjetorit është mundësuar që edhe në platformën online të eKosova të mund të shkarkohet pasqyra e gjendjes së kursimeve pensionale. Si për çdo shërbim tjetër, për këtë kërkohet hyrja (me numër personal dhe fjalëkalim) ose regjistrimi në eKosova.

Pasqyra mund të shkarkohet për "Vitin e fundit" ose "Nga fillimi" dhe është e njëjta që ofrohet në eTrusti.

Meqë pasqyra e ka tashmë Kodin Digjital (QR Code) kopja e shkarkuar në internet (në eTrusti dhe eKosova) është identike me atë që shtypet në zyrën e Trustit. PRANDAJ: PËR APLIKIMIN PËR VIZA, PËR DËSHMI TË STAZHIT TË PUNËS OSE TJETËR, NUK KA NEVOJË QË TË VIZITOHET ZYRA E TRUSTIT PËR TA MARRË PASQYRËN.

Ky është edhe një hap para për shërbime më të lehta e digjitale për kontribuuesit.

Vegja për pasqyrën e Trustit në eKosova: <https://rks-gov.net/441>

PUBLIKON

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Janar 2023

AUTOR

Jeton Demi

FOTO E BALLINËS

Brod, Prizren

ADRESA

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB

info@trusti.org | www.trusti.org

Facebook

TrustiPensional

Youtube

Fondi Pensional i Kosovës